

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Polonia dhe Lituania hartojnë plan për evakuimin ndërkufitar nga Baltiku
ADRESA	https://www.koha.net/bote/polonia-dhe-lituania-hartojne-plan-per-evakuimin-nderkufitar-n-ga-baltiku
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 01:15:31 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 15:44:40 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	536b0b90106103906a1dedd984f33d06a780c800e8fd43716f38fc2c4d39e836
TEKSTI	cb6f64eb575fcb03b87072896155a3213caeaaac20603c0616f6c89b138977da
PAMJA	480e7b06c9074337501ac6b9e2d4c1b1bc378e735fc622b821562ecfe845ded5

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5202b8616781d0dec859c020d0a6756943a59ff8e38e686c2846c6c05cfb211e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	ab3276ac2cb522ea05a9b9eebe99b70422c74012061c3bc349b5122226e7063e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5202b8616781d0dec859c020d0a6756943a59ff8e38e686c2846c6c05cfb211e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mbështete KOHËN. Ruaje të vërtetën

Kontribuo →

Letër lexuesit

BOTË

Polonia dhe Lituania hartojnë plan për evakuimin ndërkufitar nga Baltiku



Foto: Associated Press

27 shtator 2026 17:44

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përgjigdhura në kanal in tonë zyrtar në Viber

Polonia dhe Lituania kanë nisur punën për një plan të përbashkët ndërkufitar për evakuim në rast të një krize të madhe ose kërcënimi ushtarak në rajonin e Baltikut.

Plani do të mundësojë zhvendosjen e një pjese të banorëve të Lituaniës, Letonisë dhe Estonisë përtej kufirit polak.

Përgatitjet përfshijnë analizimin e procedurave, logjistikës dhe kapacitetit të infrastrukturës në të dyja vendet, raportoi të dielën "Euronews".

Vilmantas Vitkauskas, drejtues i Qendrës Kombëtare të Menaxhimit të Krizave të Lituaniës, ka bërë të ditur se puna për propozimin ka nisur tashmë. Një plan i detajuar pritet të hartohet pasi Polonia dhe Lituania të arrijnë marrëveshjen përfundimtare.

Përgatitjet po zhvillohen në kuadër të stërvitjeve lituaneze "Vyčio Skliautas 2026", të nisura më 25 shtator dhe që do të zgjasin deri më 3 tetor. Ushtrimet synojnë të testojnë sistemin kombëtar të mobilizimit dhe bashkëpunimin institucional në situata krize.

Edhe



Botë • 2 shk 2026

Pse Gjermania po stacionon prani ushtarake në Lituani

Një prej komponentëve praktikë është testimi i procedurave për evakuimin e popullsisë. Në stërvitje marrin pjesë rreth 3,000 pjesëtarë të forcave të sigurisë dhe përfaqësues të institucioneve, autoriteteve lokale, kompanive dhe organizatave joqeveritare, si dhe rreth 1,000 vullnetarë.

Në Lituani ndodhet gjithashtu një delegacion prej rreth 20 përfaqësuesish të institucioneve të ndryshme polake.

Gjatë ushtrimeve po testohen sistemet e paralajmërimit të banorëve, organizimi i pikave të grumbullimit dhe regjistrimit, transporti, si dhe lëvizja e personave të evakuar nërme

Futboll.

Portugalia mposht Norvegjinë, Ronaldo nuk luan

Showbiz.

Dua Lipa nga vendlindja: Patëm dasmë të madhe shqiptare, po na rritet rrethi

Futboll.

Kloppi pëson humbjen e parë me Gjermaninë

Sporte të tjera.

Dramë në Ferizaj, Kastrioti e fiton Superkupën për herë të parë

Arbëri.

Nata e 12-të e protestës "Jo në emrin tim", në Gjakovë protestës iu bashkua Nënë Ferdonija

Basketboll.

Bora ia shkakton Yllit humbjen e dytë

rajoneve të ndryshme.

Polonia po merr pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë në planifikimin e evakuimit ndërkufitar.

Autoritetet lituaneze kanë theksuar se stërvitjet kanë karakter trajnues dhe synojnë zhvillimin e procedurave për përballimin e krizave. Ato, sipas autoriteteve, nuk nënkuptojnë se po pritet një kërcënim i menjëhershëm.

Edhe



Botë • 22 sht 2026

Kryeministri lituanez: Jemi gati t'i kundërpërgjigjemi Rusisë

Një element qendror i planifikimit është korridori Suwałki, brez territori që lidh Poloninë me Lituaniën dhe përmes të cilit shtetet baltike lidhen me pjesën tjetër të aleatëve të NATO-s dhe Bashkimit Evropian.

Zona përmban rrugët kryesore tokësore ndërmjet Polonisë dhe Lituaniës. Në rast të një krize serioze, këto lidhje mund të jenë të rëndësishme për lëvizjen e trupave dhe furnizimeve, por edhe për evakuimin e civilëve.

“Korridori Suwałki është me rëndësi të jashtëzakonshme, si nga pikëpamja ushtarake, ashtu edhe nga ajo logjistike”, ka deklaruar Vitkauskas.

Polonia po përgatitet për mundësinë e pritjes së banorëve të evakuuar nga shtetet baltike.

Në shtator, përfaqësues nga Lituania dhe Letonia zhvilluan një vizitë studimore në Poloni, ku u diskutuan çështje që lidhen me evakuimin masiv, mbrojtjen civile, si dhe organizimin e pritjes dhe akomodimit të personave të evakuuar. Në bisedime morën pjesë edhe përfaqësues të shërbimeve dhe institucioneve polake përgjegjëse për sigurinë dhe mbrojtjen civile.

Edhe



Botë • 22 sht 2026

Inteligjenca evropiane paralajmëron për veprime vendimtare të Moskës kundër NATO-s

Lituania ka hartuar tashmë planin e saj për evakuimin e popullsisë në rast të një kërcënimi ushtarak ose krize. Një prej rrugëve kryesore të parashikuara për evakuim nis nga Vilnisi në drejtim të kufirit me Poloninë.

Ndërkohë, autoritetet e Voivodeshipit të Podlaskies në verilindje të Polonisë po përgatiten për një rol të mundshëm si korridor tranziti për banorët e shteteve baltike në rast të një situatë që do të kërkonte evakuim në shkallë të gjerë.

#POLONIA

#LITUANIA

#KUFIRI

Artikuj të ngjashëm



Botë • 15 kor 2026

Lituania thotë se Rusia po planifikon sulme në infrastrukturë



Botë • 9 qer 2026

Rusia zhvillon stërvitje detare në Baltik gjatë stërvitjeve të mëdha të NATO-s

apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësisë që e përbejnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Kushtet e përdorimit

Udhëzim për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatesisë dhe cookies

Perkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 /

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.